



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr. 1083 Prot.

Gjirokastrë, më 01.09.2023

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ në Universitetin Mesdhetar të Kretës.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Kretës hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndër-Institucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me 2 pozicione për studentë të Departamentit të Infermierisë, cikli i parë i studimit (Bachelor), viti i dytë dhe i tretë, të cilët do të angazhohen në mësimnxënie në Universitetin e Kretës. Aktivitetit mësimor do të zhvillohet gjatë vitit akademik 2023-2024, semestri i parë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht ose greqisht.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **07.09.2023**:

- vërtetim studenti;
- listë notash;
- letër interesi, në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze në nivelin B1 ose të gjuhës greke në nivelin B2;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet Universitetit të Kretës, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

